



**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVILË LËVIZJE PARALELE, DHE NGRITJE
NË DETYRË NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE**

**PËRGJEGJËS NË SEKTORIN E ZHVILLIMIT TW PROGRAMEVE KOMPJUTERIKE,
KATEGORIA III-a/1.**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve në Institutin e Statistikave shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

**Përgjegjës në Sektorin e Zhvillimit tw Programeve Kompjuterike në Drejtorinë e
Teknologjisw sw Informacionit, kategoria e pagës III-a/1.**

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE: **14 Qershor 2018**

Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NË DETYRË: **19 Qershor 2018**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Përgjegjësi i sektorit të zhvillimit të programeve kompjuterike përgjigjet tek drejtori i drejtorisë për menaxhimin e për zhvillimin, testimin, mirëmbajtjen në kohë të programeve të ndryshme kompjuterike dhe zhvillimin e sistemeve mbështetëse për këto programe, si edhe përgjigjet për krijimin e administrimin e bazave të të dhënave përkatëse.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (III-a/1, III-a)
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a - Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Master Shkencor" ne Informatike, Informatike Ekonomike, Inxhinieri Informatike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të ketë të paktën 3 vjet eksperiencë pune në profesion.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë për pozicionin
 - b- Jetëshkrim i aplikantit;
 - c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
 - d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
 - h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
 - i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
 - j- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në INSTAT, brenda **datës 14 Qershor 2018**.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **16 Qershor 2018**, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve në Institutin e Statistikave, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- _Njohuritë mbi Ligjin Nr.9180, datë 05.02.2004 “Për statistikën zyrtare”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin e Nën-punësimit Civil nr. 152/2013
- Njohuri mbi VKM nr. 303, datë 31.03.2011 "Përkrijimin e njësive të Teknologjisë së Informacionit dhe të - Komunikimit në Ministrinë e Linjës dhe Institucionet e varësisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Njohuri mbi sistemet e menaxhimit te bazave te te dhenave; http://www.kciti.edu/wp-content/uploads/2017/07/dbms_tutorial.pdf

- Koncepte mbi programimin e orientuar ndaj objekteve:
http://www.scert.kerala.gov.in/images/2015/Plustwo/comp-unit_02.pdf

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për vlerësimet e rezultateve individuale në punë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve në Institutin e Statistikave do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2. NGRITJA NË DETYRË

Në rast se pozicioni i cituar më sipër, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, vazhdon procedura e ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të INSTAT dhe në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si dhe stendat e informimit të publikut duke filluar nga data **29 Qershor 2018**.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati (Nëpunës Civil) në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë III-b, IV-a, IV-b;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vertetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a - Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Master Shkencor" ne Informatike, Informatike Ekonomike, Inxhinieri Informatike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të ketë të paktën 3 vjet eksperiencë pune në profesion.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët (nëpunës civilë) duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë për pozicionin
- b- Jetëshkrim i aplikantit;
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Institutin e Statistikave brënda datës **19 Qershor 2018**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **29 Qershor 2018**, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve në Institutin e Statistikave do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të INSTAT dhe standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;

b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;

c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve në Institutin e Statistikave do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe standat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e internetit të INSTAT, Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe standat e informimit të publikut për fazat e mëtejshme të kësaj procedure duke filluar nga data **29 Qershor 2018**.